
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA SH.A

Data: _____.____.2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: Blerje mobilje për M.E.K.I.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): Mobilje: 39100000-3

Vlera e fondit limit: 4,143,008 (katër milionë e njëqind e dyzet e tre mijë e tetë) lekë **pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I.KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP

“Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar ku përcaktohet se: Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kriteret të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.”

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet

ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar” duke qenë se vlera e fondit limit është nën vlerën e kufirit të ulët monetar.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit të kontratës**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55, pika 4/c të VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) duke qenë se vlera e fondit është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, si dhe aftësinë e tyre në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 3 (tre) punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesën e shoqërisë në momentin e hapjes së ofertave, me kualifikimet si më poshtë:

- *1 (një) marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh/ përpunues druri* vërtetuar me:
 - kontratën individuale të punës;
 - diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;
- *2 (dy) punonjës të thjeshtë* për veprimtari ndihmëse gjatë procesve të punës vërtetuar me:
 - kontratën individuale të punës;

Shenim: Kriteri nr.2 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/b/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar; Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; Vendimi 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP) të rishikuar” dhe Urdhërit nr.99, datë 25.05.2021 “Për miratimin e katalogut kombëtar të kualifikimeve profesionale”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Punonjësit me specialitet e sipërpërmendura kërkohen në përputhje të plotë me objektin e prokurimit, duke qënë se një pjesë e madhe e artikujve të kërkuara janë mobilje druri ose materiale të tjera MDF, melaminë etj, të cilat do të prodhohen/montohen/asemblohen sipas përmasave dhe specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti. Ngjyra e mobiljeve është një element që nuk është përfshirë në specifikimet teknike, pasi kjo do të përcaktohet nga Autoriti Kontraktor përfitues në momentin e realizimit, e cila do të jetë në varësi të preferencave të këtij autoriteti me qëllim përshtatjen e mobiljeve me amjentet ku do të vendosen. Argumentimi për stafin e kualifikuar të kërkuar për realizimin e objektit të prokurimit si më poshtë:

1 (një) marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh/ përpunues druri: Marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh/ përpunues druri ka njohuri të duhura në lidhje me përpunimin edhe montimin e saktë të pjesëve të mobiljeve. Ai është i aftë të zbatojë me saktësi udhëzimet teknike dhe të sigurojë që çdo pjesë e montuar të jetë në përputhje me specifikimet e kërkuara. Ky specialist ndikon në shmangjen e gabimeve që ndikojnë në cilësinë dhe jetëgjatësinë e mobiljeve, duke ulur riskun e defekteve dhe problemeve gjatë përdorimit. Cilësia, stabiliteti dhe siguria janë thelbësore për mobiljet që përdoren në ambiente publike, pasi montimi i gabuar i tyre mund të rrezikojë punonjësit që do t'i përdorin ato. Gjithashtu siguron që montimi/ assemblimi apo procese të tjera të punës të kryhen në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

2 (dy) punonjës të thjeshtë: Punonjësit e thjeshtë janë të domosdoshëm për punën ndihmëse që do të kryhet përgjatë të gjithë proceseve të zbatimit të kontratës, të cilët mund të angazhohen në ngarkim- shkarkim apo edhe gjatë procesit të montimit.

Ky numër punonjësish është minimale që operatori ekonomik ofertues, jo vetëm prodhues por edhe tregëtues, duhet të kenë për zbatimin e kontratës. Kjo krijon bindjen e Autoritetit Kontraktor se operatori ekonomik duke patur një staf të kualifikuar, garanton produkte përfundimtare cilësor, të qëndrueshme dhe jetëgjatë, të punuara në përputhje të plotë me sipërcifikimet teknike dhe me standartet e kërkuara në dokumentet e tenderit.

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- **ISO 9001:2015** “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent (e vlefshme);
- **ISO 14001:2015** “Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalent (e vlefshme);
- **ISO 45001:2018** “Për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë” ose ekuivalent (e vlefshme).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur.

ISO 9001 ose ekuivalent përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

AK Vlerëson të nevojshëm certifikimin e subjekteve ofertues me ISO 14001 ose ekuivalent, me qëllim garantimin se operatori ekonomik gëzon konfirmimet e nevojshme nga organizmi i vlerësimit të konformitetit, se ka ndërmarrë masa proaktive me qëllim minimizimin e ndikimit

negativ në mjedis, si dhe zbaton kuadrin rregullator përkatës në fuqi për mbrojtjen e mjedisit. Kjo qasje proaktive ndaj menaxhimit mjedisor mund të rezultojë në përfitime të prekshme, të tilla si reduktimi i mbetjeve, ruajtjes së energjisë dhe kursimeve të kostos.

ISO 45001 ose ekuivalent është një standard ndërkombëtar që specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë. Ai siguron një kornizë për organizatat për të menaxhuar rreziqet dhe për të përmirësuar performancën. Përfitimet e këtij kualifikimi; Kuadri për të menaxhuar në mënyrë sistematike rreziqet; Ulja e incidenteve dhe lëndimeve në vendin e punës; Përkushtim i demonstruar për shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog / skedë teknike për të gjithë artikujt objekt prokurimi, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike për secilin artikull, në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike të mallrave sipas dokumenteve të tenderit. Nëse katalogu/ët / skeda teknike janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Argumentim: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve/skedës teknike nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë Autoritetit kontraktor si Organ Qëndror Blerës verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të kërkuara.

Kërkesa për katalogun /skedës teknike ka disa avantazhe: Besueshmëria e informacionit: Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Përputhshmëria me specifikimet teknike: Siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit. Parandalimi i mashtrimeve: Redukton rrezikun e mashtrimeve ose të ofrimit të produkteve të falsifikuara.

Për sa më sipër AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të pajisjes objekt prokurimi nga Autoriteti Kontraktor përfitues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

5. Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë për periudhën minimale 1 (një) vjecare të garancisë së mallrave objekt prokurimi nga data e dorëzimit të mallit, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin e defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli i lëvruar është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti që vjen nga prodhimi ose të cilësia të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimin ose riparimi i tyre pa pagesë nga operatori ekonomik.

6. Operatori ekonomik duhet të deklarojë që merr përsipër shërbimin e transportit dhe montimin e mallrave pranë ambjenteve të Autoriteteve Kontraktore përfituese brenda afatit të parashikuar.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se do të kryejnë transportin dhe vendosjen e tyre në gjendje të plotë përdorimi, në adresat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës deklaron se artikujt objekt prokurimi do të jenë të reja, të papërdorura më parë dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të realizojnë objektin e prokurimit në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike, duke furnizuar mallra cilësorë dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë, deri në ambientet e Autoritetit Kontraktor përfitues.


Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Nr.	Emërtimi	Përshkrimi i Punimeve
1	Tavoline / post pune (te levizshme me mundesi nderlidhje me njera tjetren)	Tavoline pune modulare 120x60 cm. Struktura metalike, syprine material MDF me rimeso druri lisi. Ngjyre natyrale druri.
2	Poltron rrotullues	Baza e poltronit të jetë alumin me diametër 660 mm dhe e lyer me bojë elektrostatische në 200 C ose inoks me diametër 630mm. Rrotat të jenë të përforcuar me material termoplastik (poliamide). Bazamenti të jetë i ndërtuar nga pesë këmbë metalike me rrota të lëvizshme 360 grade. E gjithë struktura e poltronit të jetë metalike. Pistoni gazit për rregullimin e lartësisë të karriges të aktivizohet me levë që ndodhet poshtë dhe në anën e djathtë të ndenjësës. Mekanizmi revokimit të ndenjësës të jetë i përberë nga alumin dhe të lejojë tërheqjen e sinkronizuar të ndenjësës nga 11 gradë dhe mbështetësen e shpinës në 18 gradë. Rregullimi të arrihet duke tërhequr levën e vendosur më poshtë dhe në qendër të objektit. Të jetë gjithashtu e mundur për të rregulluar thellësinë e ndenjësës që të përshtatet me përmasat e trupit të përdoruesit. Ndenjësja duhet të jetë e prodhuar nga dru i presuar kompensatë me trashësi 12mm, shkume poliuretani trashësi 40 mm, e cila është e veshur me tapiceri dhe rrjetë. Pjesa e sipërme e shpinës të jetë e veshur me tapiceri ose lëkurë ekologjike ndërsa pjesa e poshtme me rrjetë. Përmasat gjatësi 740 mm dhe gjerësi 465 mm (me shpinë të lartë) ose gjatësia 580 mm dhe gjerësia 465mm (me shpinë të lartë me rrjetë dhe lëkurë në krye). Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018
3	Tavoline mbledhje	Tavoline mbledhje 110x225 cm. Struktura metalike, syprine material MDF me rimeso druri lisi. Ngjyre natyrale druri.
4	Shkallare fikse për ulje.	Shkallare fikse për ulje (shiko fletet e vizatimeve). Material MDF me rimeso druri lisi. Ngjyre natyrale druri. Ulese sfungjeri me tapiceri sipas vizatimit
5	Stola në formë kubi	Stol në formë kubi (shiko fletet e vizatimeve). Material MDF me lysterje. Ngjyra sipas brandbook
6	Rafte/Librari funksion të ndara dhe kompozim	Librari e hapur 180x45x295 cm. Material MDF me rimeso druri lisi. Ngjyre natyrale druri.
7	Ndarse / Separator xhami	Separator fiks xhami 200x295cm.
8	Perde grille për 3 dritare	Perde grille për 3 dritare me lartësi 2.5 m
9	Ulese sfungjeri/shilte	Ulese e thjeshtë sfungjeri me përmasat 45cm x 45cm për tu vendosur në sipërfaqen e shkallareve.
10	Kolltuqe komplet (3+2+1)	Skelet druri, stil modern dhe tapiceri me lëkurë ekologjike. Mbushje me sfungjer cilësor. Modeli, seti, ngjyra, etj, do të përcaktohet nga Autoriteti Kontraktor në

		momentin e lidhjes së kontratës. Në komplet do të jenë një 3 vendesh një 2 vendesh dhe një kolltuk tek. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 13759:2012 Divani 3 vendësh: 200x90xH90 Divani 2 vendësh: 170x90xH90 Kolltuku 120x90xH90
11	Reception ne formë U-je	Ky reception modern përmban sipërfaqe te melaminuar që i rezistojnë gërvishtjeve dhe njollave nga lëndët e lëngshme. Trashësia e pllakës së përdorur 18 mm. Syprina është me panele laminati ngjyrë argjendi që përputhet me xokolen e përparme të mobiljes duke theksuar rifiniturën. Katër unaza metalike gjenden në sipërfaqe për të mbajtur telat/kabllo të fshehura dhe të organizuara. Karakteristika unike e kësaj tryeze është syprina e qelqit të temperuar që duket se noton mbi sipërfaqe dhe mbështetet nga këmbëza prej metali ngjyrë argjendi. Kjo tryezë përbëhet nga dy tavolina të drejta 120cm, dy tavolina të harkuara dhe një kthim tavolinë kthimi që mund të vendosen në të dy anët. Mobilja e receptionit te jete e paisur me sirtare. Tavolinat e drejta: Min 120 x 80 x 105cm Tavolina me hark: Min 80 x 80 x 105cm Tavolina e kthimit Min 80 x 80 x 75 cm, Dimensione: Min 280 x 200 x 105 cm Max 300 x 220 x 120 cm Të plotësojë kërkesat e Standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016+A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar), SSH EN 13721:2004
12	Poltron pritje dyvendësh (kolltuk dy vendësh)	Të jetë me skelet druri. Të jetë i dizenuar me linja të drejta të stilit modern. Me tapiceri prej lëkure ekologjike të një cilësie të lartë. Sfungjeri i përdorur të jetë cilësor. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 13759 :2012 186 x 95 x 94 cm

M1 dhe M2 janë përkatësisht specifikimet me përmasat sipas vizatimit për shkallaret (Artikulli Nr.4) dhe stolat në formë kubi (Artikulli Nr.5).



Ulese sfungjeri/shilte (Artikulli Nr.9)



Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

Specifikimet teknike për disa nga artikujt sipas DST janë hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfitues, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Pjesa tjetër e specifikimeve teknike janë sipas katalogut të OBP të datës 17.05.2024.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të mallrave objekt prokurimi, autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

Transporti/montimi dhe vendosja e mallrave objekt prokurimi në ambjentet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues do të realizohet nga operatori ekonomik fitues.

NJËSIA E PROKURIMIT